

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë
"FA.GE.KO "Sh.p.k

Sot më datë 20.02.2019(dymije e nentembedhjete),unë i nenshkruari:

Z. Luigi Fazi , dtl. 14.02.1953, lindur ne Nettuno (RM) dhe banues ne , Rome Itali , shtetas italian , madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i Pasaportes nr. YB4365507 .

i cili me cilesine e "ortakut themelues "shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi , mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare me pergjegjesi të kufizuar, "FA.GE.KO "Shpk .

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria "FA.GE.KO "Shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2
Personaliteti juridik


Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria" FA.GE.KO "Shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Luigi Fazi** , i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane ,Rruga "H.Kolli", Pall Fratari, Nr 1.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Projektimin dhe Ndertimin e ndertesave per banim , si dhe tregetimin e tyre .
- Projektim dhe ndertim te objekteve private e publike, te rrueve,vepra te ndryshme industriale, vepra arti dhe monumente kulture, ndertime ne fushen e bujqesise etj.
- Prodhim te artikujve te ndryshem qe perdoren ne fushe e ndertimit si betone , inerte , mermere etj. Si dhe tregtimi i tyre ,Plan vendosje objektesh te vecanta kat 3.a,b. Projektues konstruktor.Rikonstrukcion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj.
- Ndertim ujesjelles kanalizime ,ndertim vepra kullimi , ujitje etij.
- Ndertim veprash arti te vogla deri ne 6 metra.
- Punime dheu, sistemime , tarcime terrenesh ndertime civile e konomike etj.
- Eksport -import makineri te cdo lloji , impiante industriale, atrecatura si dhe cdo tregti persa i perket mjeteve te transportit apo mjete ndertimi , produkte te tyre si dhe cdo mjet i cdo tonazhi apo lloji pa kufizim .
- Import-Eksport te pijeve alkalike te ndryshme , tregetim , magazinim , shperndarje , te pijeve alkalike ,nenprodukteve te tyre, si dhe tregetim te mallrave te tjera te akcizes .
- Eksport -Import te pajisjeve mjekesore e medikamenteve te ndryshme te cdo lloji, te pajisjeve kopiuterike dhe elektronike , te makinerive te ndryshme per transport individual dhe publik, te produkteve ushqimore , industriale kozmetike etj.
- Aktivitet ne fushen imobiliare , dhenie me qera si dhe shitje te pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme si dhe cdo aktivitet tjetet te pashprehur persa i perket e siper.
- Eksport -Import te cdo lloji materiali ndertimi .
- perpunim te metaleve , percaktimin dhe projektimin e te gjitha llojeve te makinave me fluid , projektimin , prodhimin dhe rimontimin kapital te te gjitha llojeve te hidroturbinave , hidrocentraleve , termoturbinave dhe termocentraleve .
- Riprodhim dhe riparim i pjeseve mekanike te agregateve elektromekanike si gjeneratore, elektromotor .
- Riparim dhe dhe prodhim per per makineri te ndryshme te industrise mekanike.
- Prodhim kaldajash te prodhimit et avullit , per industrine dhe termoturbinat .Ndertim i mjeteve te lundrimit remonti capital i agregateve elektromekanike qe disponojne keto mjete .
- Projektim dhe prodhimin e konstruksioneve ndertimore metalike i urave ne konstruksion metalik .Projektim dhe ndertim i konstruksioneve metalike per ndertim serash per frutikulture e bujqesi.
- Import-Eksport, tregetim me shumice dhe pakice i produkteve dhe artikujve te meposhtem :
 - Te gjitha llojete e inpueteve te ndryshme bujqesore , i ushqimit te njerzeve dhe kafshve me origjine bimore dhe shtazore , i plehrave kimike dhe organike, farerave dhe fidaneve bujqesore dhe dekorative , produkteve te mbrojtjes se bimeve ,(pesticide , insecticide , fungicide , herbicide dhe ekstrakte dhe vajrave heterike) .
- Certifikimin dhe mbledhjen e detyrimve tatimore dhe pasurore .
- Aktivitetin e reklamave publike dhe administrimin e impianteve publicitare ne pronesite e pushtetit local ose te te treteve .
- Administrimin e sherbimeve administrative per llogarine e vet , te shoqerive te lidhra ose

Handwritten signature in blue ink.

- te kontrolluara per llogari te te treteve , sherbime informative , telematike dhe telefonike .
- Administrimin e rrjeteve informative dhe telematike .
 - Mbeshtetjen dhe realizimin e projekteve te shperndarjeve te teknologjive multimediale dhe te informacionit , te imazhit , te sigurise , kontrollit dhe te mbeshtetjes se sherbimeve per qytetaret .
 - Zhvillimin e government dhe te dixhitalizimit te procedurave administrative .
 - Zhvillimin , administrimin dhe perdorimin e teknologjive te imazhit dhe grafikes .
 - Konsulece financiare , konsulence fiskale ,konsulence menaxhimi te biznesit ,konsulece per perzgjedhje e struktures juridike dhe administrative , konsulence per forma te mira te financimit dhe te investimit , ofron parashikime mbi termat financiare dhe ekonomike te cilat jane te lidhura ngushte me vijushmerine e aktivitetit .
 - Zgjidhje per probleme dhe ceshtje qe dalin gjate veprimtarise ne lidhje me vleresimin dhe mbarevajtjen e investimit.
 - Analizon strukturen financiare,Bilancin, Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe Cash-Flow .
 - Konsulence dhe informacion mbi lehtesirat fiskale , konsulence mbi problematikat fiskale , kontabile dhe bilancin , Sherbime kontabiliteti ,mbajtje te llogarive kontabel , regjistrimet dhe deklarimet e librave ,pergatitjen e pasqyrave financiare ne perputhje me standartete kontabilitetit shqiptare , dhe te tjera raporteve financiare te kerkuara nga aksioneret , keshilla profesionale ne lidhje me strukturen , paraqitjen dhe zbulimin e pasqyrave financiare , ndjekje e procedurave te likuidimit dhe falimentit te shoqerise .
 - Keshillim ligjor dhe financiar vecanarisht keshillim ne fushen e se drejtes tregtare , taksave , prokurimeve publike , koncensionet dhe privatizimet , pronesine intelektuale dhe te drejttat e autorit , si dhe cdo fushe te se drejtes ne pergjithesi .
 - Perfqaesimi i shoqerise tregtare , individeve apo cdo entiteti tjeter me personalitet juridik ne cdo proceure adiministrative apo gjyqesore ne Republiken e Shqiperise apo jashte saj .
 - Hartimi i raporteve ekonomiko-financiare mbi shoqerite tregtare dhe personat e tjere juridik/fizik , kryerja e cdo lloj aktiviteti qe lidhet me veprimtarine e agentit , brokerit , komisionerit , ndermjetesit pa u kufizuar nga veprimtaria qe kryhet nga porositesi apo cdo pale tjeter .
 - Shitje dhe blerje elektronike , telefonie , online,etj.

Neni 5

Kohezqatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

Leq. Kuc

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem " i shoqerise :

Z. Luigj Fazi , zoterues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 100 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit

sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte **Z. Luigi Fazi**, emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje.


Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen



e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të ortakut të vetem;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këto raste Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej

tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi hartohet ne 4 ekzemplarë ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKU I VETEM

Luigi FAZI

